



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Priljeft/Prodato Received/Delivery	01. 11. 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHËRBIMIN CIVIL	6635/2022		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.800/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.800/2022, të datës 15.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër përgjigjes së zyrës së personelit në Komunën e Klinës të datës 09.09.2022, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.10.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.800/2022 e datës 15.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën "Përgjegjës i zyrës për familjet e Dëshmorëve, Invalidëve dhe viktimave civile" në Komunën e Klinës sipas Akt Emërimit me 02Nr.112-2856/11 të datës 01.08.2011, nëpërmjet e-mailit më datë 15.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër përgjigjes së zyrës së personelit në Komunën e Klinës të datës 09.09.2022 për shkak të mos zbatimit të vendimit për pagesën e shtesës të nxjerr nga Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Klinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa Këshilli më datë 03.10.2022, me numër protokollit 5812/2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Klinës, me shkresat e bashkangjitura.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.protokolli 5425/2022 të datës 15.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga [redacted] për [ankesa.kpmschk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschk@rks-gov.net) i datës 15.09.2022; Vendim nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me numër 03Nr.120-22061/2019 i datës 05.06.2019; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 09.09.2022; E-mail nga [redacted] për A.B. i datës 09.09.2022; Shkresë e datës 05.06.2019; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 26.09.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 5812/2022 e datës 03.10.2022; E-mail nga [redacted] për B.G. i datës 29.09.2022; Akt Emërim i [redacted] me numër 02Nr.112-2856/11 i datës 01.08.2011; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme të përgjithshme - Gjmnazin të [redacted] me numër 13301/1 e datës 22.02.2012; Përshkrimi i Detyrave të Punës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi [redacted] sipas Akt Emërimit me numër 02Nr.112-2856/11 të datës 01.08.2011 është i punësuar në Komunën e Klinës, në pozitën "Përgjegjës i zyrës për familjet e Dëshmorëve, Invalidëve dhe viktimave civile". Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me datë 05.06.2019 ka nxjerr Vendim me numër protokoll 03Nr.120-22061/2019 me të cilin i lejohet shtesa në pagë meqenëse stafi i Drejtorisë realizojnë këtë shtesë në vlerë 45.76 Euro duke u bazuar në nenin 91 të statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke marrë parasysh se stafi i drejtorisë së shëndetësisë marrin shtesë e shëndetësisë sipas shtojcës 44, mirëpo i njëjti asnjëherë nuk është kompensuar në bazë të vendimit. Ankuesi përmes e-mailit zyrtar më datë 09.09.2022 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit në komunën e Klinës për ekzekutimin e shtesës në pagë të shëndetësisë në vlerë prej 45.76 euro duke filluar nga muaji Qershor 2019. Udhëheqësi i Personelit në komunën e Klinës përmes e-mailit zyrtar me datë 09.09.2022 i është përgjigjur nëpunësit civil dhe të njëjtin e ka udhëzuar se Drejtoria kompetente që e ka lëshuar vendimin është ajo që duhet të bëjë ekzekutimin përmes Drejtorisë së Financave.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i pakënaqur me përgjigjen e zyrës së personelit të komunës së Klinës të datës 09.09.2022 kërkon që ti bëhet kompensimi i shtesës në pagë në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 05.06.2019 e deri në zbatimin e vendimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke pasur parasysh faktin që ankuesi mban statusin e nëpunësit civil, dhe se shtesa është dhënë nga Drejtori i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale në emër të pagesës së shtesës për stafin shëndetësor, atëherë sipas Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, janë përcaktuar shtesat mbi pagën bazë për nëpunësit civil, konkretisht neni 20 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. 1.6. 1.7. 1.8, ka përcaktuar se: 1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënësisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit", ndërsa Rregullorja Nr. 33/2012 për



Shtesat në Pagë dhe Kompensime Tjera të Nëpunësve Civil konkretisht neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. 1.2. 1.3. 1.4. 1.5. përcakton se: 1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të kompensohen në këto raste: 1.1 për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2 për punën jashtë orarit gjatë fundjavës; 1.3. për punën jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. për kohën e pushimit vjetor; 1.5. për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes. Prandaj Kolegji ka konstatuar se vendimi i Drejtorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i datës 05.06.2019 për dhënien e shtesës e cila shtesë ka të bëjë me stafin shëndetësor është i nxjerrur në kundërshtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe Rregullorja Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime Tjera të Nëpunësve Civil.


Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda A.nr.800/2022

Çlirim ZEKA

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Klinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Klinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

